

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Dixhitalizimi I Arkives”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): sherbime programimi per aplikacione

VLERA E FONDIT LIMIT : 25.000.000 (njezete pese milion) leke pa TVSH.

Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 254.712,175(dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë presje njëqind e shtatëdhjetë e pesë) euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 31.12.2024 është 98.15 euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10.*

b. Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 500.000 (peseqind mije) lekë.

Shuma e kërkuar e sigurimit te ofertes ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 5.094,24 (pesë mijë e nëntëdhjetë e katër presje njëzet e katër) euro.

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 31.12.2024 është 98.15 euro.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 43, pika 1, pika 2 b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne nenin 43 , pika 1 , pika 2 , si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021,2022,2023) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar.

Nëse kërkohen bilance të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik” dhe nenit 19, pika 2, të VKM Nr. 498, datë 1.8.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, të ndryshuar.

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2024)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.2.4.Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2024 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të ofruara,

ose,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të ofruara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

c) Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

$$40\% \times 25.000.000 = 10.000.000$$

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik certifikatat përkatëse të vlefshme sipas standardeve ndërkombëtare ISO, të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e

Akreditimit (DPA) ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së procedurës së prokurimit publik:

Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombetare ISO me certifikimet e mëposhtme:

-Certifikate për menaxhimin e cilësisë ISO 9001:2015;

-Certifikate për menaxhimin e sigurisë së informacionit ISO 27001:2013.

Për të përmbushur këtë kriter operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat e vlefshme ISO. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili prej operatorëve duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

ISO 27001:2013 :Njohja është një nga vlerat më të rëndësishme të një organizate në sigurimin e vazhdimësisë së biznesit.Në rast se shumë pasuri janë humbur, informacioni i humbur nuk ka ekuivalent monetar. Për këtë arsye, në kushtet që ndryshojnë dhe zhvillohen sot, rëndësia e informacionit dhe domosdoshmëria e mbrojtjes po rritet gradualisht. informacionit; Ajo mund të përdoret dhe të ruhet me shkrim, media elektronike, verbale, kujtesa e punonjësve dhe shumë formate të tjera. Për shkak të përparimeve teknologjike, shumë prej këtyre formave të përdorimit mund ose nuk mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Për shkak të këtij ndryshimi dhe zhvillimi, siguria e informacionit duhet të pyetet vazhdimisht dhe kontrollohet. Siguria e informacionit është mbrojtja e konfidencialitetit, integritetit dhe përdorshmërisë së informacionit.

ISO 27001 Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit është një sistem menaxhimi që përfshin njerëzit, proceset dhe sistemet e informacionit në sigurimin e informacionit të korporatave

të informacionit dhe mbështetet nga menaxhmenti i lartë. Është hartuar për të mbrojtur asetet e informacionit dhe për të siguruar kontrolle adekuate dhe proporcionale të sigurisë që i japin besim palëve të interesuara. Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit ISO 27001 përfshin strukturën e korporatave, politikat, aktivitetet e planifikimit, përgjegjësitë, aplikacionet, procedurat, proceset dhe burimet.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar prej te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, punonjës të diplomuar në fusha si shkencë kompjuterike, teknologji informacioni, inxhinieri informatike, duke pasur çertifikime dhe specializime sipas kërkesave të mëposhtme:

Kërkesat për Stafin Teknik:

Specializimet dhe Certifikimet e Kërkuara:

3 (tre) Specialist të Certifikuar në Cilësinë e Softuerit (ISTQB CTFL)

Sigurojnë zbatimin e praktikave më të mira dhe standardeve më të larta të cilësisë në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e softuerit, duke siguruar që të gjitha fazat e ciklit të zhvillimit të jenë në përputhje me metodologjitë e kontrollit të cilësisë.

2 (dy) Punonjës të certifikuar si zhvillues software në gjuhën e programimit Java/PHP ose ekuivalente.

Punonjësit e certifikuar në Java dhe PHP janë të domosdoshëm për një sërë arsyesh sepse ofrojnë:

- *Ekspertize Teknike, (ekspertiza në të dyja gjuhët ndihmon që projekti të zhvillohet në mënyrë efikase dhe profesionale).*
- *Diversifikim të Projektit, krijim i zgjidhjeve të nderthuara*
- *Siguri dhe Cilësi, kod të sigurt e të optimizuar dhe zbatim i praktikave më të mira*
- *Mirëmbajtje dhe zhvillim i sistemeve ekzistuese*

1(një) Specialist i Certifikuar në Baza të Dhënash (Oracle),ose ekuivalente

Njohuri të thella mbi projektimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të bazave të të dhënave, duke garantuar integritetin dhe performancën e lartë.

- Ekspertize teknike të thelluara, kjo siguron që baza e të dhënave të jetë e qëndrueshme, e sigurt dhe e optimizuar për performancë maksimale

- Siguria e bazave të të dhënave, duke mbrojtur të dhënat nga akses i paautorizuar dhe sulmet kibernetike.

- Optimizimi i performancës, për të përmirësuar efikasitetin e përgjithshëm të sistemit.

- Mirëmbajtje dhe përditësime, punonjësi është i aftë të kryejë mirëmbajtje rutinore dhe të zbatoshë përditësime pa ndërprerje të mëdha dhe reduktim i rrezikut dhe gabimeve gjatë përditësimeve ose migrimëve.

- Perputhshmeria me standartet dhe rregulloret (GDPR)

1 (një) Punonjës të certifikuar si menaxher projekti nga institucione të akredituara dhe ose nderkombetare në metodologjine Agile si PMI-ACP, Prince 2, ose ekuivalente
Menaxhim efektiv i projektit, fleksibilitet dhe përshtatje të shpejtë ndaj ndryshimeve.

- *Rritje e efikasitetit dhe produktivitetit, duke siguruar që burimet të përdoren në mënyrë optimale që projekti të përfundojë në kohë dhe brenda buxhetit*
- *Menaxhimi i rreziqeve dhe kontrollit të cilësisë, duke garantuar dorëzimin me cilësi të lartë të projektit e monitoruar gjatë gjithë kohës proceset e punës në ciklin e projektit*
- *Perputhshmeria me praktikën globale, sigurimi i transparencës dhe përfshirjes së klientit në çdo fazë të projektit.*

1 (një) Punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente).

Një punonjës i certifikuar në ITIL ose ekuivalente është i rëndësishëm për menaxhimin efikas të shërbimeve IT sepse ofron:

- *Permiresimin e menaxhimit të shërbimeve IT në mënyrë të strukturuar*
- *Optimizimin e proceseve dhe efikasitetit duke i automatizuar dhe standartizuar*
- *Permiresimin e cilësisë së shërbimeve*
- *Perputhshmeria me standartet nderkombetare*
- *Menaxhimi i ndryshimeve dhe rreziqeve*

1 (një) Punonjës të certifikuar si Analist Biznesi ose ekuivalente.

- *është thelbësor për të përmirësuar proceset e të sigurojnë suksesin e projekteve.*
- *Identifikimi i Kërkesave të klientit dhe shmangien e keqkuptimeve midis palëve të interesuara dhe ekipit teknik.*
- *Përcaktimi i Prioriteteve dhe Siguron që burimet të përdoren në mënyrë optimale.*
- *afërsisht të menaxhojë ndryshimet në kërkesat e projektit pa ndikuar negativisht në afatet dhe buxhetin.*
- *Rritja e Cilësisë së Produktit dhe Shërbimeve, duke ndihmuar në zhvillimin e produktit dhe shërbimeve që përmbushin pritshmëritë e klientit.*
- *Mbështetja për Transformimin Dixhital dhe Inovacionin, ndihmon klientin të përshtatet me teknologjitë e reja dhe të zhvillojë strategji për transformimin dixhital.*
- *Parandalon keqkuptimet dhe mungesën e qartësisë që mund të çojnë në dështimin e projektit.*
- *Ky siguron që proceset e analizës së klientit të jenë në përputhje me standartet globale.*

1 (një) Punonjës të certifikuar për trajnues mbi nivelin bazik.

- *Një trajnues i certifikuar zotëron aftësi për të krijuar programe trajnimi të përshtatura sipas nevojave specifike të klientit*
- *Përdorimi i Metodave të Avancuara të Mësimdhënies, kjo ndihmon pjesëmarrësit të kuptojnë më mirë konceptet dhe t'i zbatojnë ato në praktikë.*

- Trajnuesi ndihmon në përmirësimin e aftësive teknike dhe të buta (soft skills) të punonjësve, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e produktivitetit dhe efikasitetit të tyre.
- Një trajnues i certifikuar siguron që trajnimi i ofruar përputhet me standardet më të mira ndërkombëtare dhe nevojat e industrisë.
- Trajnimet cilësore krijojnë një ndjenjë investimi në zhvillimin profesional të punonjësve, duke përmirësuar motivimin dhe kënaqësinë e tyre në punë.

Shënim: Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikime të mësipërme.

Dokumentacioni i Kërkuar për Stafin Teknik:

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve të mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- **Diplomën Universitare** përkatëse, për secilin punonjës të kërkuar më lart.
- **Kontratën e Punës** përkatëse, për secilin punonjës të kërkuar më lart.
- **CV Personale**, për secilin punonjës të kërkuar më lart.
- **Deklaratë për Ekspertët/Specialistët Përgjegjës**, të nënshkruar nga operatori ekonomik.
- **Certifikatat Përkatëse të Vlefshme**, për secilin punonjës të kërkuar më lart, të lëshuara nga organizma të akredituar nga Republika e Shqipërisë ose nga vendi i origjinës.
- **Listëpagesat Sipër e Sig25** për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi, ku të përfshihet stafi i mësipërm, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, Pjesa III, Pika B.

Diplomimi: Të paktën 3 (tre) prej tyre duhet të jene diplomuar në fushën e Teknologjisë së Informacionit, si Inxhinieri Informatike, Shkenca Kompjuterike apo fusha të ngjashme.

Periudha e Angazhimit: Punonjësit duhet të jenë të angazhuar për një periudhë minimale prej 3 (tre) muajsh.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, të gjithë operatorët së bashku duhet të zotërojnë dokumentet e mësipërme, dhe çdo operator ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas zërave të shërbimeve që do të ndërmerë apo realizojë sipas marrëveshjes.

Shënim: Për plotësimin e pikave të mësipërme operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.